**BISHZ - VAIS – UIAS**
BASHKIMI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR
VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELLEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ
UNION DES INTELECTUELS ALBANAIS EN SUISSE
UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA • Mühledorfstrasse 13 • 3018 Bern • Email: sekretariati@bishz.ch • www.bishz.ch

SEKRETARIATI / SEKRETARIAT
SECRÉTARIAT / SEGRETERIA

**Konto / Compte / Conto:** **30-169532-9**

⑩
VJET PUNE
**TË BASHKIMIT TË INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR**

- Këshillit Organizues për Ndriqimin e Historisë Shqiptare
- Anëtarëve të LAPSH-Gjenevë
- Anëtarëve dhe Miqve të BISHZ-së

| Referenca juaj / Ihr Zeichen<br>Votre référence / Vostro riferimento | Referenca jonë / Unser Zeichen<br>Notre référence / Nostro riferimento | Bernë |
|---|---|---|
| | Njoftim / Ftesë | 29.04.2007 |

Njoftim/Ftesë për pjesëmarrje në promovimin e pesë vëllimeve me titull "E Djathta Shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike" të grup-autorësh shqiptarë

Të nderuara Zonja, të nderuar Zotërinj;

Ju njoftojmë dhe njëherit ju ftojmë të merrni pjesë në promovimin e pesë vëllimeve me titull "E Djathta Shqiptare në mbrojtje të Shqipëri-së Etnike" të grup-autorësh shqiptarë, që organizon BISHZ në bashkëpunim me Lidhjen e Arsimtarëve dhe Prindërve Shqiptarë (LAPSH) të Gjenevës dhe me Këshillin Organizues për Ndriqimin e Historisë Shqiptare (KONHSH). Në promovim do të marrin pjesë, veprimtarë, intelektualë shqiptarë dhe zvicëran, dhe gazetarë nga Zvicra dhe trevat shqiptare. Vëllimet e përmendura të shkruara në gjithsej 2006 faqe janë botuar nga Shtëpia Botuese "Lumbardhi" nga Prizreni.

*Promovimi i vëllimeve do të organizohet në dy pjesë, të shtunën më 5 maj 2007 në Gjenevë, sipas programit të bashkangjitur.*

Pjesa e parë e promovimit mbahet prej orës 14.30 deri në ora 16.00 në Panairin e Librit "PALEXPO" në Gjenevë, Stenda L, Shtëpia për shpërndarjen e Librit "Botimpex" nga Tirana, me ç'rast do të flasin ligjërues të ndryshëm.

Pjesa e dytë e promovimit, me vështrimet e ligjëruesve nga BISHZ-së, bashkëpunëtorët e saj dhe nga KONOSH mbahet prej orës 18.00 deri në ora 19.30 në lokalet e Universitetit Popullor Shqiptar në Gjenevë (Adresa: 112, rue de Lyon, 1211 Genève 13). Në këtë pjesë, përveç referimeve, do të keni kënaqësinë të shprehni mendimet tuaja përmes një debati të hapur me bashkëkombas shqiptarë për rru-gët, kahjet dhe mundësitë të cilat çojnë drejt bashkimit kombëtar me të Djathtën Shqiptare drejt Shqipërisë Etnike. Mbrëmja do të fre-skohet me pika të ndryshme argëtuese nga artistët tanë prezentë.

Me nderime dhe përshëndetje të sinqerta,

B I S H Z B e r n ë

Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar

Mobile: +41 (0) 79 311 4780
E-Mail: ahmet.xhigoli@bishz.ch
Internet: http://www.bishz.ch

*Shojcë: Programi i promovimit*

# Programi

## Pjesa e parë: Promovimi në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Gjenevë

14:30 Fjala përshëndetëse dhe hapja e promovimit ( Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar i BISHZ-së / Valbona Krasniqi anëtare e Kryesisë në LAPSH/BISHZ )

14:40 Vështrim i shkurtër i punës së pesë vëllimeve: "E Djathta Shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike" të grup-autorësh shqiptarë ( Nue Oroshi, Selman Etemi, Magjun Smaili, etj. )

15:20 Diskutim i hapur, pyetje dhe përgjegjëje

16:00 Përfundimi i promovimit në Panair

## Pjesa e dytë: Promovimi në Universitetin Popullor Shqiptar (UPSH) në Gjenevë

HYMNI

18:00 Fjala hyrëse, përshëndetja e pjesëmarrësve dhe mysafirëve ( Abas Fejzullahi, sekretar i BISHZ-së / Valbona Krasniqi anëtare e Kryesisë në LAPSH/BISHZ )

18:05 Vështrim i shkurtër i vëllimit të parë ( Magjun Smaili )

18:10 Pjesë muzikore me flautë–Hymni ( Abetare Balaj )

18:15 Vështrim i shkurtër i vëllimit të dytë ( Driton Kajtazi )

18:20 Pjesë muzikore me kavall ( Kristë Veseli )

18:25 Vështrim i shkurtër i vëllimit të tretë ( Ramadan Hoxha )

18:30 Këngë e kënduar nga Sami Gashi shoqëruar me instrumente popullore nga Kristë Veseli

18:35 Vështrim i shkurtër i vëllimit të katërt ( Valbona Krasniqi )

18:40 Pjesë artistike: recital shoqëruar me tingujt e kavallit luajtur nga Kristë Veseli

18:50 Vështrim i shkurtër i vëllimit të pestë ( Selman Etemi )

18:55 Këngë kënduar nga Motrat Stojkaj

19:00 Diskutime

19:30 Mbyllja e promovimit ( Abas Fejzullahi, sekretar )